

Mendim paralel

Une Valbona Sanxhaktari, anëtare e trupit gjykues që shqyrton çështjen për subjektin e rivlerësimit Alfred Balla, shprehem dakord me ndërprejen e procesit të rivlerësimit për subjektin rivlerësues Alfred Balla, por me një arsyetim tjetër të ndryshëm nga ai i shumicës së trupit gjykues.

Në vlerësimin tim zoti Alfred Balla, në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, ligjërisht ushtronte funksionin e ndihmësit ligjor në organikën e Gjykatës së Lartë, duke plotësuar në këtë mënyrë përcaktimin e pikës 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit ex officio. Në vlerësimin tim, interpretimi i vendimeve të organeve të tjera apo marrja e tyre në vlerësim nga Komisioni nuk mund të përbëjnë një bazë ligjore për tu vlerësuar, pasi rëndësi ka vetëm statusi ligjor që gjendet subjekti në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, si dhe vullneti apo qëndrimi i subjektit në raport me ecurinë e procesit të rivlerësimit. Ndodhur në këto kushte zoti Alfred Balla ose duhej ti nënshtrohej procesit të rivlerësimit kalimtar, ose duhej ti nënshtrohej dispozitave të nenit “G” të aneksit të kushtetutës. Referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Apelit për raste të ngjashme, aplikimi i nenit 103 të Kodit të Procedurës Administrative mund të aplikohet në ato raste kur objekti është bërë i pamundur sepse subjekti rivlerësues nuk mund të ushtroj më funksionin ose asnjë funksion nga ata të përcaktuar sipas nenit “G” të aneksit të kushtetutës, për shkak se ka humbur përfundimisht aftësinë për punë.

Duke vlerësuar situatën ligjore si dhe dokumentacionin në dosjen e subjektit të rivlerësimit zotit Alfred Balla, vlerësoj se trupi gjykues duhet të kish vijuar me ndërmrëjen e procesit të rivlerësimit duke aplikuar nenin “G” të Aneksit të Kushtetutës. Ky arsyetim nuk i referohet rethanës konkrete/statusit juridik, në të cilën ndodhet zoti Balla, pasi në analizë të fakteve ajo duket një situatë juridike korrekte dhe plotësisht legjitime, por parimit të përgjithshëm të vendosur nga ligjbërësi sipas aneksit të kushtetutës, e që mund ti referohet pozitës juridike të këtij subjekti rivlerësimi në të ardhmen.

Në përfundim vlerësoj se në rastin konkret, ndryshe nga sa ka konkluduar shumica, nuk jemi në kushtet që çojnë në përfundimin e këtij procedimi pa një vendim përfundimtar, por, subjekti ndodhet në kushtet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit sipas nenit “G” të aneksit të Kushtetutës.

Valbona Sanxhaktari

Anëtare